

## **Ankesë Formale drejtuar Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës**

I nderuar Këshill i Mediave të Shkruara të Kosovës,

Në cilësinë time si gazetar, drejtues i revistës "The Frontliner", dhe blogut politik 'Gunpowder Chronicles' — dëshiroj të parashtroj një ankesë formale lidhur me një artikull të publikuar në seksionin "Verifikimi i Fakteve" të gazetës online "Reporteri.net". Ky artikull, i cili nuk ka një autor të identifikueshëm, përmban një numër shkeljesh të rënda të Kodit Etik të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Vegëza: <https://reporteri.net/fact-check/skandali-i-rtk-se-cka-e-qysh-ndodhi/>

### **Natyra e Artikullit**

Së pari, artikulli është ofruar lexuesve si një "Verifikim Faktesh", por në fakt, është një pjesë e mbushur me opinione dhe me motive të qarta politike. Kjo përbën një keqpërdorim të etikës gazetareske dhe është një keqëbërje e madhe. Një verifikim i vërtetë faktesh duhet të bazohet në të dhëna të sakta dhe të verifikuara dhe të mos përmbajë opinione apo motive të fshehura politike.

### **Shkeljet e Kodit Etik të Mediave të Shkruara të Kosovës**

- 1. Respektimi i së Vërtetës Faktike dhe e Drejta e Publikut për të Ditur të Vërtetën (Neni II.1)**
  - Artikulli në fjalë nuk respekton të vërtetën faktike. Ai përmban pretendime të pabazuara dhe opinione të autorëve të tij të pidentifikuar, duke i paraqitur ato si fakte.
- 2. Mbështetja në Burime të Identifikueshme të Informacioneve (Neni II.2)**
  - Artikulli nuk mbështetet në burime të identifikueshme dhe të besueshme për informatat e tij, veçanërisht kur përmend lidhjet e mia me mediat e tjera, dyshimet dhe dëshmitë për Gabriel Escobar.
- 3. Dallimi i Qartë Ndërmjet Lajmeve dhe Opinioneve (Neni II.3)**
  - Artikulli nuk bën dallim të qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Ai përmban opinion të kamufluar si fakt, çka i çon lexuesit në konfuzion.
- 4. Ndalimi i Shpifjes dhe Fyerjes (Neni II.4)**
  - Artikulli përmban insinuata dhe fyerje ndaj integritetit tim profesional, duke pretenduar se jam një gazetar "i vetë-deklaruar". Kjo është shpifje dhe pretenduar se DASH ka thënë këtë apo atë për mua, por duke dështuar t'i ofroj lexuesit mundësinë për t'i lexuar gjetjet e mia, përpjekje kjo e qartë për të diskredituar reputacionin tim.
- 5. Korrigjimi i Informacionit të Pasaktë (Neni II.5)**
  - Nuk është bërë asnjë përpjekje për të korrigjuar informacionet e pasakta ose për të siguruar një balancë duke përfshirë reagimin tim ndaj akuzave të bëra.
- 6. Shtrembërimi dhe Keqpërdorimi i Deklaratave (Neni II.8)**
  - Artikulli keqpërdor dhe shtrembëron deklaratat e mia dhe ato të DASH, duke lënë të kuptohet se unë jam "dezinformator", pa shpjeguar se jam një gazetar i njohur ndërkombëtarisht.

## 7. Verifikimi i Fakteve (Neni II.1, II.2)

- Artikulli nuk angazhohet në verifikimin e fakteve dhe nuk ofron asnjë provë që të mbështesë pretendimet e tij dhe akuzave ndaj meje, artikulli ka dështuar të verifikoj faktet në plotëni, duke qenë se është fakt që unë jam një gazetar i pavarur me kredibilitet të plotë i njohur ndërkombëtarisht nga mekanizma ndërkombëtar siç është Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve dhe Dera e Akreditimit në Britani të Madhe nëpërmjet Unionit të Gazetarëve Britanik, duke shkelur kështu normat bazë të verifikimit të fakteve.

## Deklaratat e Pabazuara dhe Përgjegjësia Gazetareske

Reporter.net sugjeron se unë kam qenë burim informacioni për artikullin e "Slobodna Bosna", pa ofruar asnjë provë për këtë pretendim. Përderisa 'Slobodna Bosna' i referohet artikullit tim në artikullin e tyre të dytë pas shkrimit tim që unë e kam gjetur të arsyeshme të shkruaj në saje të pretendimeve të tyre dhe ku në pjesën e <sup>1</sup>dytë të artikullit që unë i referohem raportimit të "Slobodna Bosna" brenda gjuhës profesionale dhe kodit etik e shkruaj këtë "Nëse financimi i tij gjurmohet te burime të dyshimta (siç sugjerohet nga artikulli raportues i "Slobodna BOSNA") ose te entitete të huaja me interesa të caktuara, kjo do të konfirmonte më tej rolin e tij si një propagandist i rrezikshëm i cili kërcënon sigurinë kombëtare, dhe jo si një gazetar i pavarur apo një organ mediatik."

Artikulli gjithashtu insiston se investigimi im mbi <sup>2</sup>Gabriel Escobar është i pabazuar, duke injoruar faktin se ky investigim është i dokumentuar sipas standardeve gazetareske dhe është miratuar nga redaktorë Britanikë dhe Amerikan.

Artikulli gjithashtu insiston se unë i kam "targetuar" disa media dhe figura publike në Kosovë. Kjo nuk është e vërtetë, unë profesionalisht me të drejtë iu kam kundërpërgjigjur të gjitha shkrimeve që janë përpjekur të insistojnë pavërtetësisht se unë jam burim informacioni i një media boshnjake.

Artikulli madje e konsideron "targetim" ose sulm edhe <sup>3</sup>kritikën time profesionale ndaj moderatorit dhe gazetarit të TV T7 Arsim Lanit. Ju lutem, si ka mundësi që një kritikë profesionale të klasifikohet si sulm ose targetim?

## Mungesa e Balancës dhe Informimit të Plotë

Artikulli nuk informon lexuesit se kam mohuar akuzat dhe i jam <sup>4</sup>përgjigjur akuzave me profesionalizëm — për një fushatë të motivuar politikisht kundër meje nga Escobar dhe bashkëpunëtorët e tij. Po ashtu, nuk përmend që Departamenti i Shtetit ka pasur mundësinë të japë versionin e tyre të ngjarjeve dhe kanë qëndruar zyrtarisht të heshtur. Nuk përmend faktin që disa OJQ kanë dështuar të ofrojnë dëshmi të komunikimit të tyre me Departamentin e Shtetit, duke shkelur kështu parimet e transparencës dhe saktësisë

---

<sup>1</sup> Nën Hijen e Vuçiqit: Manipulimi Mediatik në Kosovë — [FRONTPOW](#).

<sup>2</sup> Gabriel Escobar's Diplomacy Under Fire — [FRONTLINER](#).

<sup>3</sup> Gazetaria e Papërgjegjshme e Arsim Lanit: Kërcënim për Sigurinë Kombëtare dhe Besimin Publik — [FRONTPOW](#).

<sup>4</sup> OJQ-ja kosovare, "S Bunker", javën që shkoi udhëhoqi një sulm të koordinuar ndaj besueshmërisë së revistës "Frontliner", me qëllim të parandalimit të leximit të gjetjeve tona. Si dhe Çfarë Ndodhi? — [FRONTPOW](#).

## Përfundim

Duke marrë parasysh të gjitha pikat e mësipërme, kërkoj nga Këshilli i Shtypit të Kosovës të shqyrtojë me seriozitet këtë ankesë dhe të marrë masa të përshtatshme për të siguruar që "Reporter.net" të respektojë <sup>5</sup>Kodin Etik të Mediave të Shkruara të Kosovës. Integriteti i gazetarisë dhe besimi i publikut në media janë në rrezik kur artikuj të tillë publikohen pa përgjegjësi dhe pa respektuar standardet etike.

*P.S: Ju lutem kini vëmendje ndaj fusnotave, ato përmbajnë artikuj të rëndësishëm referent që shërbejnë si dëshmi për t'i mbështetur pretendimet e mia në këtë ankesë. Çdo shkronjë emëruese me ngjyrën e kaltër është vegëz/link që çon në artikullin përkatës.*

Me respekt,

Vudi Xhymshiti

Kryeredaktor i "The Frontliner"

Blogu Politik — Gunpowder Chronicles — <https://www.frontpow.uk/>

Revista në Gjuhën Shqipe — <https://www.frontpow.uk/s/revista>

FRONTLINER Magazine — <https://frontliner.uk/>

---

<sup>5</sup> Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës — [KMSHK](#).